



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 11.

Prishtinë, më 30. 01.2018 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu -Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Fitore Pacolli dhe Adem Hoxha.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE, NDI, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, Blerta Deliu- Kodra, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së mbajtura më 20.12.2017, 22.12.2017 dhe 16.01.2018;**
- 3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2017;**
- 4. Miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20.12.2017, 22.12.2017 dhe 16.01.2018.

Procesverbalet, e mbledhjeve të dt. 20.12.2017, 22.12.2017 dhe 16.01.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2017

Kryetarja lidhur me raportin tha se janë paraqitur aktivitetet dhe puna e komisionit gjatë sesionit vjeshtor 2017. Ajo i pyeti anëtarët se a kanë propozime apo vërejtje.

Kryetarja konstatoj se një zëri u miratua Raporti i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2017.

3. Miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018

Kryetarja tha se në këtë propozim të Planit të punës së komisionit janë pasqyruar aktivitetet kryesore e që janë shqyrtimi i Projektligjeve dhe amendamenteve nga komisionet funksionale nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me zbatimin e agjendave evropiane dhe me përmbushjen e kriterëve dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit të BE-së për Kosovën, si dhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, sa i përket përmbushjes së agjendës evropiane, po ashtu edhe në këtë draft janë të integruara edhe propozimet e ekspertit kroat Daniell Montekar, i angazhuar nga GIZ.

Duke pasur parasysh që është vetëm një draft- plan i ftoi deputetët që me propozimet e tyre të plotësohet dhe ndryshohet ky plan.

Ilir Deda tha se ne e kemi keqkuptuar rolin e këtij komisioni sepse jemi bërë vetëm pranues të dokumenteve të tjerëve. Ne nuk e kemi vetëm këtë rol, në raport nuk po e shoh as në janar, e as në shkurt, diskutim për Strategjinë e BE-së për zgjerim. Për ta përmbushur rrugëtimin tonë na duhen 5 vizita të Komisionit, në raport nuk kemi planifikua udhëtim në Bullgari, e cila e ka presidencën, nuk kemi planifikuar udhëtim në Rumani, e cila e ka pasur para Bullgarisë presidencën dhe as nuk i kemi bërë parapërgatitjet të shkojmë në Austri, e cila e ka presidencën tjetër, pasi 18 muajt e ardhshëm janë kyç për Ballkan! Ne këtu po sillemi më të dobët se ndonjë organizatë e thjeshtë, andaj propozoj që mos të miratohet ky plan, por brenda dy javëve të formohet një grup punues dhe ta formojmë një agjendë më proaktive dhe t'i planifikojmë vizitat të cilat janë të rëndësishme për integrim të Kosovës, duhet të shikohet se a mundet para qershorit të shkohet në Bruksel dhe patjetër edhe në vjeshtë dhe të kontaktohet me ministrin e punëve të jashtme dhe atë të integriteteve evropiane dhe të vendoset saktë java se kur do të shkohet se përndryshe do ta humbim mundësinë që e kemi.

Fatmire Kollçaku pajtohet me propozimin e parafolësit që brenda dy javëve të formohet një grup punues dhe të inkorporohen të gjitha propozimet dhe sugjerimet e anëtarëve të komisionit, kurse sot tha mund ta miratojmë planin në parim e pas dy javësh të plotësohet.

Milaim Zeka tha se duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e këtij komisioni propozoj që në plan të përfshihen vizitat nëpër vendet të cilat nuk e kanë njohur akoma Kosovën dhe janë anëtar të BE-së. Kurse pikën të ndryshme kërkoj nga kryetarja e Komisionit të njoftojë lidhur me vizitën e fundit të delegacionit për MSA-në në Parlamentin Evropian, sepse disa anëtarë në takimet me deputetët e Parlamentit Evropian me sjelljet e tyre atje dhe sjelljet kur janë kthyer që janë krenuar që nuk është aprovuar rezoluta e përbashkët mes delegacionit të Kosovës dhe parlamentit Evropian.

Kryetarja u pajtua që të diskutohet në pikën të ndryshme për këtë çështje, por tha se Komisioni për MSA-në e ka kryetarin e vet dhe në atje kemi qenë si anëtarë të delegacionit të përzgjedhur nga grupet parlamentare, megjithatë secili i ka bindjet dhe qëndrimet e veta politike.

Armend Zemaj propozoi që të miratohet plani, sepse tha se ky është vetëm një draft dhe temat mund të dalin pas çdo takimi dhe nuk do të thotë se çdo gjë aty është koncize dhe të kufizohemi brenda tij, nëse ka propozime që të inkorporohen në plan, le të dërgohen në administratë që të inkorporohen, kurse propozimet që dalin kohë pas kohe Komisioni duhet t'i shqyrtojë dhe t'i fusë në agjendën e komisionit, mendoj se dinamika e punës së komisionit do të jetë shumë më e madhe se kjo çka është futur në draft.

Zenun Pajaziti propozoi që të miratohet në parim Plani i punës ashtu si është, me një deklaratë shtesë që brenda dy javësh propozimet e mundshme të inkorporohen, por duhet ta konsiderojmë që plani i punës së Komisionit me qenë një dokument që pas 5 apo 6 muajve, që nëse ka kërkesë të veçantë mu shqyrtuar dhe ritrajtuar.

Kryetarja tha se u pajtuam parimisht që plani mund të plotësohet kurdo herë, varësisht prej lëvizjeve që ne do t'i kemi sepse do të jetë një agjendë bukur e ngjeshur dhe varësisht prej temave në t'i ftojme ministrat në raportim, si dhe organizatat që mund të na ndihmojnë në punën e tij, pajtohemi që brenda dy javëve ta plotësojmë me propozime dhe në pjesën e dytë ta ftojme ministrin e Administratës Publike dhe të diskutojmë lidhur me çështjet që u diskutuan.

Andaj pas diskutimeve e hodhi në votim draft- Planin e punës së Komisionit dhe pas votimit konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2018 me mundësi plotësimi

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, dhe tha se çështjet që rregullohen me këtë projektligj nuk janë të rregulluara deri më tani me legjislacionin e BE-së, por mbetet kompetencë e brendshme, andaj mund ta rekomandojmë për miratim në Kuvend.

Armend Zemaj tha se vërtet qëndron se këto çështje nuk rregullohen me legjislacionin e BE-së, por vlera e Unionit Evropian është barazia para ligjit dhe barazia sociale,

ndërsa tendenca e çdo institucioni që të rregullojë në mënyrë të njëanshme, qoftë pagat dhe privilegjet është e padrejtë në sistemin tonë të përgjithshëm funksional dhe kjo po krijon dallime dhe atakime, andaj ne urgjentisht kemi nevojë që ta thërrasim Ministrinë e Administratës Publike që të shohim edhe nga prizmi i integriteteve evropiane, sidomos në ligjin për pagat dhe në pjesën e benefiteve të krerëve të institucioneve dhe institucionet të tjera që janë në sistemin e drejtësisë, është e pa pranueshme që disa institucione që pas përfundimit të mandateve, ju ka lejuar me ligj Kuvendi i Kosovës benefite të përjetshme dhe po ju lënë mundësinë që çdo bartësi të institucioneve të vendosë në bazë të vullnetit të tij dhe në kundërshtim me logjikën e ligjit dhe shfrytëzimit të zbrazëtirave ligjore që ka Republika e Kosovës. Andaj do të abstenoj nga ky votim sepse në të kaluarën ju kemi lejuar institucioneve të tjera, pa i përmendur me emër që të kenë benefite të përjetshme.

Ata që mbesin anash dhe atakohen në mënyrë permanente janë deputetët e Kuvendit të Kosovës, kur dihet se ligji në atë kohë është suspenduar nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa Kuvendi i ka pajisur me beneficione të përjetshme krerët e Gjykatës Kushtetuese, siç po kërkohet edhe në ligjin për presidentin e Kosovës.

Fatmire Kollçaku tha se ky ligj rregullohet nga secili shtete veç e veç, por shteti ynë duhet të sillet konform situatës që ndodhemi si shtet, e jo të sillemi si shtetet shumë më të pasura që kanë shumë më tepër barazi sociale, ku nuk do të bjerë në sy aq shumë tendenca e individëve dhe krerëve institucional që t'ju rregullohet statusi aktual i zyrtarëve të lartë shtetëror, në vend se ta rregullojnë situatën aktuale deri sa i ushtrojnë postet, por duke i shkelur ligjet në fuqi një anshëm i rrisin pagat qind për qind, duke u thirrur në përgjegjësit që i ushtrojnë, dhe këtë do ta dëshmojë Gjykata Kushtetuese se është bërë shkelje.

Jam kundër votimit jo vetëm të këtij ligji, por kundër çdo beneficioni që tentohet të rregullohet, qoftë edhe institucionin e Presidentit dhe tendenca që të sigurohet dikush përjetësisht ku 50% e popullatës jetojnë në varfëri të skajshme dhe pa e pasur asnjë ligj të unifikuar të sistemit pensional për tërë popullatën, e jo të jenë lineare me një kriter të fundit që është përgatitja shkollore. Prandaj duhet ta ftojme ministrin e Administratës Publike që të flasim për Ligjin për pagat, për reformim të sistemit pensional dhe në rregullimin e çështjes së popullatës në përgjithësi, e mandej mund të shkojmë në kategori të veçanta në një të ardhme kur të forcohemi në aspektin ekonomik dhe mund të mendojmë eventualisht që presidenti apo ish- kryeministri mund të thirren në atë që kanë ushtrua një post të lartë, por për momentin privilegjet që i gëzojnë krerët institucional.

Milaim Zeka tha se çështja e meritave më tepër ju takon votuesve mu përcaktuar se kush e meriton me qenë deputet apo jo, në çështjet konkrete që po flasim pa hyrë në fushata elektorale, jam kundër këtij ligji, për deri sa jemi duke e ndërtuar shtetin dhe nuk jemi parlament funksional që i bënë kontroll ekzekutiv, sepse po t'i bënim kontroll ekzekutivi nuk do t' i kishte rritur rrogat! Ne kemi agjenci e pa varura që janë nën kontrollin e parlamentit dhe sillen absolut si mini- Qeveri, agjencitë janë të pa varura, por janë të varura nga institucionet e Kosovës. Sa i përket rrogave, ne jemi mini- mbretëri, kurse në aspektin funksional nuk jemi askund dhe mbi bazën e kësaj jam kundër këtij ligji dhe çdo privilegji.

Fitore Pacolli u shpreh se është kundër këtij ligji. Ajo tha se në vend se t'ju ndihmojmë dhe të jemi të barabartë me shtresat të cilët janë duke jetuar në gjendje të rëndë ekonomike, ne po ju japim privilegje njerëzve të cilët janë në funksione të larta,

por po i harrojmë njerëzit të cilët janë në gjendje të rëndë dhe nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit, pastaj njerëzit të cilët janë në mbështetjen e ndihmës sociale të cilëve ju ndalohet ndihma fëmijëve po sa t'i mbushin 5 vjet.

Po flasim kur në Kuvend nuk është votuar për shtimin e numrit të edukatoreve për fëmijët me nevoja të veçanta, pra këto çështje nuk po votohen në Kuvend, kurse kur po vihet për privilegjet e presidentit, kryeministrit po i shtyjnë përpara për votim. Andaj ne, si deputetë dhe komision duhet të shtyjme të krijojmë një shoqëri të barabartë sepse kjo është rëndësia e integritit evropian, e jo të krijojmë privilegje për të pasurit, por të krijojmë kushte për të ndihmuar ata të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit.

Zenun Pajaziti tha se një përgjegjësi e jona si deputet në 10 -vjetorin e shtetit të pavarur kishte me qenë mirë me pasur sa më shumë projektligje që janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve të vendit dhe i kemi disa në radhë, me lejoni të kthehem kah diçka tjetër, ajo çka ndodhi me deklarin e Agjencia Kundër Korrupsionit për pagat e qeverisë, aspak mua nuk me entuziazmon me u marr me asnjë projektligji të tillë, aq me tepër si deputetë padrejtësisht jemi adresuar ne për privilegjet tona, e ndërkohë për tre mandate nuk kam votuar asnjë herë diçka që ka të bëjë me pagën time. Ne, si deputetë, nuk është mirë të flasim për pagat e zyrtareve te agjencive dhe benefitet e tyre, sepse ne vetëm po flasim, e nuk po veprojmë asgjë. Ne duhet t' i marrim përgjegjësitë dhe të marrim nisma ligjore dhe me ec përpara.

Pasi që ky projektligj nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe nuk e di sa është e rëndësishme, ne si komision me dhënë ndonjë opinion të caktuar.

Armend Zemaj tha se ajo që kemi bërë në të kaluarën si deputetë është se ju kemi dhënë privilegje të përjetshme disa kategorive institucionale në Republikën e Kosovës, qoftë për Gjykatën Supreme, Gjykatën Kushtetuese dhe për kryeprokurorin dhe rritja marramendëse e pagave agjencive, neve krejt çka na duhet është të marrim nja 6 nënshkrime për ta marrë një iniciativë ligjore, me përgatitur 2 amendamente të përgjithshme për nja 2 muaj procedurë, që këto privilegje me i shkurtuar me përfundimin e mandatit gjithmonë duke e ruajtur institucionin, krejt çka duhet është me pasur vullnet politik, i cili deri me tani ka munguar, neve na duhet shqyrtimi i strategjisë që ka të bëjë me nivelimin e pagave në Republikën e Kosovës dhe tek atëherë mundemi me e pasur një pasqyrë të qartë se çka po duam.

Ahmet Isufi tha se ne përpara e kemi një ligj në të cilin duhet të bazohemi, sa i përket analizës që i bahet do të bazohemi në atë se të gjitha institucionet e vendit duhet të kenë përgjegjësitë dhe privilegjet që shkojnë krahas me nivelin institucional që e përfaqësojnë.

Duhet t' i përmbahemi temës në të cilën jemi, kemi të bëjmë me Projektligjin për Presidentin, çdo vend e rregullon me ligj këtë çështje me specifikat që i kanë, andaj edhe ne duhet ta rregullojmë me specifikat që i ka Kosova, por edhe institucionet duhet të funksionojnë me ligje dhe përfaqësuesit e institucioneve duhet t'i kenë edhe përgjegjësit dhe privilegjet që ju takojnë dhe kjo duhet të jetë në harmoni me interesat shoqërore.

Ilir Deda tha se për këtë projektligj që e kemi sot po shihet se komisioni nuk ka vullnet me e përkrah sepse shumica janë kundër, atëherë ne çka mundemi me bërë është që pas votimit me i rekomanduar seancës që mos të votohet.

Kryetarja tha se nuk domethënë se janë shumica kundër, sepse ne e hedhim në votim dhe i shohim votat.

Milaim Zeka u ndërlidh dhe tha se ndoshta po keqkuptohemi, unë do te votojë kundër në Parlament, por nuk jam kundër me bllokuar ligjin, mos me proceduar në Kuvend, në komision jam për me votuar.

Pastaj iu drejtua deputetes Pacolli dhe tha se nuk është mirë që në emër të njerëzve me nevoja të veçanta me bërë fushatë, sepse ju e keni propozuar ligjin pa konsultë paraprake dhe kjo ju ka dështuar amendamentin, dhe çdo dështim i amendamentit është minus për juve dhe opinioni nuk e merr këtë si plus.

Fitore Pacolli e kundërshtoi dhe tha se nuk është fushatë se ju keni votuar kundër.

Zenun Pajaziti tha se mandati ynë i komisionit është me u deklaruar lidhur me përputhshmërinë, e Acquin, kurse grupet parlamentare duhet me trajtuar projektligjin, e mandej votimi përfundimtar me qenë, prandaj këtij Projektligji i duhet një proces deri në finalizimi për çka nuk duhet të paragjykojë se si do të jetë vendimi përfundimtar.

Kryetarja tha se Komisioni Funkcional e ka shqyrtua Projektligjin dhe e ka deleguar në Komisionin tonë

për me e shikuar përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së dhe komisioni vendos për atë fushë specifike se është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së apo jo. Lidhur me çështjen e pagave që u përmend me të drejtë nga parafolësit, ne në takimin e parë me znj. Apostolova, lidhur me pagat e zyrtarëve të lartë e kemi theksuar se është nevojë që përfundimisht ta kemi një ligj që i kategorizon këto paga, në radhë të parë ta kemi një kategorizim të pagave, e pastaj në bazë të kategorizimit të jetë paga e zyrtarëve të lartë. Ne në shkurt e kemi paraparë raportimin e ministrit të Administratës Publike që ta diskutojmë dhe rregullojmë që mos të ketë rritje ad-hoc të pagave.

Pas diskutimeve **Kryetarja** e hodhi në votim Projektligjin dhe pas votimit nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Të ndryshme

Kryetarja tha se gjatë diskutimeve u hapen disa tema për të cilat mund të diskutojmë në këtë pikë, z. Zeka e përmendi çështjen e Komisionit të MSA-së, është e vërtetë që kemi qenë anëtarë të komisionit të deleguara nga grupet tona parlamentare, ku kanë qenë prezent të gjitha partitë politike në Strazburg. Ka pasur seancë ku janë diskutuar disa pika të rendit të ditës përfshirë edhe amendamentin që është diskutuar gjatë ditëve të fundit. Ne kemi votuar ashtu si i kemi pasur qëndrimet tona politike në grupet tona parlamentare, ka pasur diskutime të mëdha dhe është paralajmëruar që do të ketë një takim të dytë në pranverë dhe vjeshtë në Prishtinë ku do të vijnë përfaqësuesit e Parlamentit Evropian.

Milaim Zeka tha se informacionin nuk e kam marrë prej asnjë anëtari të delegacionit, duke përfshirë edhe shefin e grupit parlamentar të partisë sime, por informacionin e kam marrë prej ndërkombëtarëve, sepse nëse është e vërtetë që kenë pasur konfrontime me një personalitet të madh suedez, i cili ka deklaruar se shqiptarët e besimit katolik janë shumë të diskriminuar në Kosovë, me të kam punuar për 10 vjet në Suedi dhe ka qenë nga gazetarët më të famshëm evropian që i ka mbrojtur të drejtat e shqiptarëve, luftën në Kroaci dhe Bosnje. Andaj lind pyetja si ka mundësi që një njeri aq i informuar që ka qenë me Llunaqekun në Kosovë dhe e ka një informacion kaq të gabuar.

Qëndrimi i AAK-ës në media, po ashtu, ka qenë shokuese sepse pjesëtarja e asaj partie është krenuar që nuk është miratuar Rezoluta në Parlamentin Evropian dhe kjo për mendimin tim do të duhej të ishte temë e një seance të jashtëzakonshme të Parlamentit të Kosovës, kjo për mua është shumë serioze sepse delegacioni nuk e ka aprovuar një rezolutë, e cila ka qenë në mënyrë absolute brenda kornizës kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ilir Deda u ndërlidh në diskutim dhe tha se neve na duhet një raport me shkrim dhe me na informuar në mënyrë substanciale diskutimet, kundërshtimet e delegacionit, është skandaloze sepse jemi vendi i vetëm në Ballkanin perëndimor i cili nuk ka arritur me e bërë një deklaratë me komisionin e përbashkët.

Andaj duke e pasur parasysh këtë situatë urgjentisht në këtë javë dhe në javën e ardhshme të ftohen ministri i Punëve të Jashtme dhe ministrin e Integritimeve Evropiane, sepse izolimi i Kosovës duhet diskutuar në këtë Parlament se çka mund të bëjmë e pastaj vijmë raportet e rregullta.

Kjo tregon se ky komision duhet me pasur dinamikë me të shtuar të punës dhe me pasur takime më të shpeshta.

Armend Zemaj theksoj se Komisioni për Integritime Evropiane dhe Komisioni i MSA-së janë të ndara, por mbi të gjitha e kanë një lloj agjende të përbashkët edhe pse ajo merret vetëm me pjesën kontraktuale që e ka për herë të parë të nënshkruar me BE-në, raporti do të vijë sepse është publik dhe lidhur me këtë LDK ka kërkuar debat parlamentar. Është e vërtetë ajo çka po përflitet për delegacionin, komisioni nuk ka pasur probleme me njëri-tjetrin, por problemet kanë qenë konceptuale për gjendjen që po kalon Kosova dhe këto janë qëndrime që janë mbajtur.

Ajo çka është për të ardhur keq është pse nuk është votuar Rezoluta dhe pse ka ardhur në pikëpyetje raporti BE –Kosovë dhe pse ky angazhim i viteve të tëra është vu në pikëpyetje për një veprim që po konsiderohet nga shumica i papërgjegjshëm. Janë këto 3 çështje të cilat ne duhet t'i përmirësojmë sepse përndryshe do të kthehemi në regres.

Sa i përket eurodeputetit suedez, ai e ka shprehur një shqetësim në bazë të një informacioni që e ka pasur një burimor, që me një ngjarje të caktuar nuk lejohet kryerja e riteve fetare protestante në Kosovë, kemi biseduar gjatë për atë temë dhe njëri prej diskutuesve kam qenë edhe unë, arsyetimi ka qenë shumë korrekt, ashtu qysh na takon se ne kemi vlerë për harmoni fetare, kemi garantuar dhe se kësi shembuj nuk kemi dëgjuar, por kjo mund të jetë e ndonjë personi që kërkon azil në vendet evropiane, por jo ndonjë shqiptari në Republikën e Kosovës. Kam biseduar personalisht edhe me eurodeputetin dhe e kam kuptuar se është mik i Kosovës dhe ia kam bërë me dije se këto tema janë larg për individ apo grupe fetare dhe me ligj u garantohet liria fetare të gjithëve, por pastaj ai u bind disi që ndoshta mundet me qenë keq i informuar. Krejt këto çka u thanë duhet t'i ketë parasysh komisioni ynë dhe ai i MSA-së, takimi është ndërprerë për shkak të një amendamenti që ka qenë heqja dorë nga tendenca e

shfuqizimit të Gjykatës Speciale dhe implementimit të saj sipas ligjeve të Kosovës, por gjithçka që është biseduar do të informoheni me raport dhe transkript si gjithnjë.

Kryetarja shtoi se deklarata e eurodeputetit ka zgjuar reagime dhe kundërshtime edhe nga disa deputetë të Parlamentit Evropian që kanë qenë njohës të rrethanave në Kosovë, si znj Llunaqek ,Tanja Fajon, e disa të tjerë, se nuk qëndron që protestantët në Kosovë nuk mund t’ i kryejnë lirshëm ritet fetare.

Zenun Pajaziti tha se liberalizimi i vizave është ai segmenti që duhet me na nxitur për të bërë pak më shumë brenda BE-së, Parlamentit dhe me vendet që nuk na kanë njohur më parë ka qenë British Council që ka pasur një mbështetje në një projekt që atëherë nuk ka shkuar për mes një Komisioni të caktuar, por për mes disa deputetëve të parlamentit dhe ai projekt është zhvilluar me njerëz të shoqërisë civile dhe të tjerë, që kanë ndikuar që me i bërë disa vizita me vendet që nuk na kanë njohur, ka qenë jashtëzakonisht i mirë, por është ndërprerë dhe neve tani na duhet një ndërmjetësim i tipit të British Council dhe duhet t’i gjejmë mënyrat.

Tani pozicionet kanë ndryshuar për faktin që ambasada aso kohe ka pasur një vullnet më të madh, por tani pozicionet kanë ndryshuar për shkak të BREX-it dhe duhet me i pa mundësitë se cila ambasadë do të na kishte mundësuar që me pasur qasje me këto shtete.

Milaim Zeka tha se nuk është vlerë me fol anglisht, por vlerë me menduar anglisht. Nëse ne shkojmë në Parlamentin Evropian dhe flasim anglisht e mendojmë shqip e bëjmë bërlllok. Ne kur shkojmë atje e përfaqësojmë Kosovën, duhet të flasim për temat për të cilat shkojmë atje, andaj propozoj që të ftohet një seancë e jashtëzakonshme me temën pse nuk është aprovuar Rezoluta?

Ahmet Isufi tha se nuk keni nevojë të bëhemi më anglez se anglezët, por mbroni identitetin dhe qëndrimet e shtetit tuaj, flisni shqip se njihet edhe gjuha shqipe në Evropë. Flisni si duhet, mos flisni tema që i komplikojnë raportet sepse në fund të fundit me Malin e Zi do t’i kemi gjithmonë raportet, sepse jemi fqinjë dhe çështjen e Gjykatës Speciale dhe demarkacionit janë çështje të ndjeshme për vendin tonë dhe nuk është mirë me luajt herë kështu, e herë ashtu.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra
